



Imagination
Ideas Inspiration
Innovation
Negotiation
Networking
Novelties
Necessities
Coordination
Concepts
Competences



Nr. 54

Viti i pestë i botimit

Nëntor 2017

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- 2 Tetori, Dita Botërore e Habitave; 4 Tetori, Dita Botërore e Kafshëve
- Inagurohet Qendra e Informacionit në Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan
- Takimi i II-të i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës
- Përkujtohet Java Europiane e Pyjeve
- Presidenti i INCA në Forumin e Politikave Bujqësore 2017
- Bashkëbisedime me grupet e interesit për problematikën e menaxhimit dhe identifikimin e impakteve negative në Parqet Kombëtare
- Mblidhet Grupimi Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë
- Tryezë të rrumbullakët me mediat - Procedurat e VNM/VSM
- Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?
- Shoqëri pjesëmarrëse në vendimmarrje / nga Qendra EDEN
- Kuriozitete nga Zonat e Mbrojtura në Shqipëri
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se
51 vjet më parë ...

...me VKM nr. 96, datë 21.11.1966 shpallen Parqe Kombëtare, kryesisht ekosistemet pyjore, si më poshtë:

1. Thethi, me sip. 2630ha; 2. Lura, me sip.

1280ha; 3. Llogara, me sip. 1010ha; 4. Bredhi i Drenovës, me sip. 1380ha; 5. Dajti, me sip. 3300ha dhe 6. Pisha e Divjakës, me sip. 1250ha.

Aktualisht, bazuar në dispozitat e ligjit "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, disa prej tyre kanë ndryshuar sipërfaqen, duke

Vijon në faqe 2



Institute for Nature Conservation in Albania
Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

Vijon nga faqe 1 ruajtur statusin e Parkut Kombëtar.

Parku Kombëtar "Thethi", sipas studimit të ri që po kryhet, do të përfshihet në sipërfaqen e Parkut Kombëtar Ndërkufitar "Alpet e Shqipërisë", me sipërfaqe të përgjithshme 86 mijë ha.

Parku Kombëtar "Dajti", me VKM nr. 402, datë 21.06.2006, u rishpall "Park Kombëtar" me sipërfaqe të zgjeruar 29,384.18ha, i shtrirë në Qarkun e Tiranës dhe të Durrësit.

Parku Kombëtar "Pisha e Divjakes", me VKM nr. 687, datë 19.10.2007, u rishpall Park Kombëtar "Divjakë-Karavasta", me sipërfaqe të zgjeruar 22.230.2 ha, në të cilin përfshihet edhe pjesa e territorit në administrim të Kavajës (Gosë) dhe Fierit (Libofshë). Gjithashtu, pjesë e Parku Kombëtar, u bë dhe laguna e Karavastasë, me sip. 5000 ha, e cila sipas VKM nr. 102, datë 15.1.1996 kishte statusin "Rezervat Strikt Natyror". Njëherazi, ky territori, si ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur, ka statusin e Zonës Ramsar, me VKM nr. 413, datë 22.8.1994...

... 12 vjet më parë ...

...me VKM nr. 684, datë 02.11.2005, shpallet zona shqiptare e Liqenit të Shkodrës "Rezervat Natyror i Menaxhuar", ndërsa me VKM nr. 682, datë 02.11.2005, shpallet "Peizazh ujor/tokësor i mbrojtur" zona e lumit Buna, së bashku me delten dhe ishullin e Franc Jozefit, rezervatin e Velipojës, lagunën e Vilunit, plazhin e Baks-Rrjollit, kënetën e Domnit, si dhe territoret përreth tyre.

Për Rezervatin Natyror të Menaxhuar "Liqeni i Shkodrës" është hartuar dhe plani i menaxhimit (Qershor të vitit 2012), i miratuar me urdhër të Ministrit të Mjedisit nr. 815, datë 21.11.2012, por që fatkeqësisht nuk po zbatohet, pasi ka disa kundërshti në lidhje me zonimin e territorit dhe të mungesës së fondeve.

Me VKM nr. 683, datë 02.11.2005, sipërfaqja prej 49,562.0ha, e cila përfshin Liqenin e Shkodrës sëbashku me Lumin e Bunës dhe zonat ligatinore përreth tyre, të shpalljen zonë natyrore veçanërisht të mbrojtur dhe përfshirjen në listen e Konventës "Ramsar", "Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë"...

... 7 vjet më parë ...

...me VKM nr. 995, datë 03.11.2010, ekosistemi natyror ligatinor i deltës së Lumit Mat, laguna e Patokut, Godulla dhe delta e Lumit Ishëm, me sip. 5000.7ha, shpallet "Rezervat Natyror i Menaxhuar".

VKM nr. 693, datë 10.11.2005, rishpall "Park Kombëtar" territoret natyrore të kompleksit ligatinor të Butrintit deri tek Kepi i Stillos, me sip. 8591.2ha. Për këtë park është hartuar dhe plani i menaxhimit (Shtator 2010), i miratuar me urdhër të Ministrit të Mjedisit nr. 404, datë 09.06.2011, por që nuk ka gjetur zbatim.

Njëherazi, territori natyror i kompleksit ligatinor të Butrintit (Liqeni i Butrintit, Parku Kombëtar i Butrintit, Kepi i Stillos, ishujt e Ksamilit) ka statusin e Zonë Natyrore veçanërisht e mbrojtur, për t'u përfshirë në listën e Konventës "Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë", me sipërfaqe të përgjithshme 13,500.0ha.

VKM nr. 881, datë 03.11.2010, caktoi vendet për vendosjen e antenave të komunikimit dhe të atyre radiotelevizive në territorin e Parkut Kombëtar "Mali i Dajtit"...

... 5 vjet më parë ...

...miratohet ligji nr. 111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore". Ligj synon: a) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre; b) sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit; c) shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit të efektshëm të tyre; ç) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike; dhe d) përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor, për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe interesave sociale dhe ekonomike të vendit...

2 Tetori, Dita Botërore e Habitave

Kombet e Bashkuara kanë përzgjedhur të hënën e parë të Tetorit si Ditën Botërore të Habitave në përkujtim të përvjetorit të konferencës së parë Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara mbi kolonizimet njerëzore, mbajtur në Vankuver, Kanada në 1976-ën.

Qëllimi i ditës Botërore të Habitave është ti kujtoj botës përgjegjësitë e saj në të ardhmen e habitave të qëndrueshme mjedisore. Edhe në Shqipëri prej disa vitesh ka filluar të ndërmerren nisma të ndryshme dhe aktivitete ndërgjegjëse në kuadër të kësaj dite.



4 Tetori, Dita Botërore e Kafshëve



OCTOBER 4

www.worldanimalday.org.uk

Dita Botërore e Kafshëve i ka fillesat e saj në vitin 1931, në Konventën e Ekologjistëve të mbajtur në Firence, Itali, si një mënyrë për të hedhur dritë mbi vështirësitë e llojeve të rrezikuara. Më pas, kjo ditë u shndërrua në një ditë festive për të gjithë ata që duan kafshët, në të gjitha llojet e tyre.

Organizimi i Ditës Botërore të Kafshëve mobilizon lëvizjen për mirëqenien e kafshëve, duke e shndërruar atë në një forcë globale për ta bërë botën një vend më të mirë për të gjitha kafshët. Kjo ditë festohet në mënyra të ndryshme në çdo vend, pa marrë parasysh kombësinë, fenë, besimin apo bindjet politike. Përmes rritjes së vetëdijes dhe edukimit ne mund të krijojmë një botë ku kafshët të njihen si qenie të ndjeshme dhe ti kushtohet gjithmonë vëmendje mirëqenies së tyre.

Inagurohet Qendra e Informacionit në Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan

Radhimë - Vlorë, 6 Tetor 2017 - Në kuadër të Ditës Botërore të Turizmit dhe Vitit Ndërkombëtar të Zhvillimit të Turizmit të Qëndrueshëm 2017, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi inaguroi Qendrën e Informacionit në Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan, e cila do t'i shërbejë turistëve që duan të vizitojnë këtë Park Kombëtar. Në ceremoni ishin të pranishëm dhe Z. Nino Merola, Drejtor i Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Z. Brian J. Williams, Koordinator i Përhershëm i OKB dhe Përfaqësues i Përhershëm i UNDP, Drejtori i Agjencisë



Vijon nga faqe 3 Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Z. Zamir Dedej, përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, përfaqësues të sektorit të turizmit në Rajonin e Vlorës, të Projektit NaturAL, UNDP, AdRZM Vlorë, AKZM. Qendra e vizitorëve në Parkun Kombëtar shoqërohet me informacion të bollshëm, të plotë dhe atraktiv, duke pasur në fokus vendosjen në pah të autenticitetit të natyrës sonë, e cila përbën një ndër asetet kryesore të turizmit shqiptar.



Gjithashtu kjo qendër do të jetë një mjet i nevojshëm për Administratorët e Parkut për të orientuar dhe kontrolluar fluksin turistik, për të krijuar bazë të saktë të dhënash për vizitorët dhe aplikimit të tarifave për hyrjet dhe shërbimet që ofron parku. Në këtë kuptim qendrat janë një hap i rëndësishëm drejt një menaxhimi më efektiv dhe të qëndrueshëm të ZM-ve në Shqipëri, duke u orientuar drejt



synimit për vetëfinancimin e tyre, si dhe një mënyrë e mirë për të orientuar vizitorët drejt aktiviteteve që nuk dëmtojnë ose rrezikojnë



vlerat e zonës.

Qendra e Vizitorëve e Parkut Kombëtar Detar Karaburun-Sazan në Radhimë është lokalizuar në një pikë strategjike për promovimin e parkut të parë dhe të vetëm detar në Shqipëri, duke qenë lehtësisht e aksesueshme nga vizitorët, pasi ndodhet shumë afër zonës ku nisen anijet



turistike që ofrojnë ture në Karaburun- Sazan dhe mjetet e vogla të lundrimit.

Ekrani interaktiv do të shërbejë si një mjet i shkëlqyer dhe do të krijojë mundësinë e përcjelljes së informacionit në sa më shumë gjuhë të huaja. Ekrani lejon përshtatjen dhe shtimin e informacionit me një kosto jo të lartë. Ndërtimi i Qendrës së Informacionit në Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan në Radhimë dhe trajnimi i personelit, ka kushuar rreth 50 mijë dollarë dhe është një bashkëpunim mes UNDP-së, WWF, INCA-s.

Takimi i II-të i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës

Tiranë - 10 Tetor 2017 - Në ambientet e INCA u zhvillua takimi i dytë koordinues i Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës.

Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte diskutimi i planit të punës, mbarëvajtja e aktiviteteve përgjatë dy muajve që lamë pas, si dhe diskutimi i aktiviteteve të Rrjetit në të ardhmen.



Ky takim zhvillohet në kuadër të projektit "Promovimi dhe adresimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura", pjesë e programit SENIOR-II Albania (Senior Albania), zbatuar nga REC Shqipëri, financuar nga qeveria suedeze (Embassy of Sweden in Tirana).

Adresimi i problematikave me cilat përballen Zonat e Mbrojtura si dhe promovimi i vlerave të këtyre zonave përmes zërit të shoqërisë civile dhe komunitetit lokal, është fokusi kryesor i këtij projekti. Ai ka si objektiv të përgjithshëm të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura nëpërmjet forcimit të rolit aktiv dhe pjesëmarrës të Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile.



Përkujtohet Java Evropiane e Pyjeve



9-13 October 2017

Për herë të parë Java Evropiane e Pyjeve u festua në vitin 2008 dhe që nga ajo kohë ka ofruar një mundësi unike për pjesëmarrësit për të rritur dukshmërinë e sektorit pyjor dhe për të ndikuar në diskutimet pan-evropiane dhe globale lidhur me pyjet.

Palët e interesuara inkurajohen të kontribuojnë dhe të organizojnë festimet kombëtare dhe lokale.

Presidenti i INCA në Forumin e Politikave Bujqësore 2017

APF 2017 (Forumi i Politikave Bujqësore) mbledhi mbi 130 aktorë relevantë, të cilët ndanë mendime mbi politikat bujqësore dhe zhvillimin rural në Ballkanin Perëndimor dhe ofruan rekomandime për përmirësimin e situatës aktuale.



Forumi i Politikave Bujqësore (APF) 2017 u organizua nga Grupi Permanent i Punës për Zhvillim Rural në

Evropën Juglindore në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Malit të Zi, në Podgoricë, më 11 dhe 12 Tetor. Ajo mbledhi mbi 130 përfaqësues të autoriteteve publike relevante, civile dhe sektorit privat, nga rajoni dhe jashtë. Zgjerimi i punësimit dhe mundësive për investime në zonat rurale si dhe përdorimi i drejte dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore do të ulë migrimin nga zonat rurale. Ballkani Perëndimor duhet të konsolidojë veprimet e nevojshme për të krijuar një zonë ekonomike rajonale në përputhje me acquis e BE-së për të eliminuar pengesat e aksesit në treg, uljen e kostos së tregtisë dhe për të tërhequr



më shumë investime.

Presidenti i INCA, Dr. Genti Kromidha, mori pjesë në APF 2017 dhe prezantoi raportin mbi Menaxhimin e Burimeve natyrore në vendet e Evropës Jug-lindore. Raporti bën një vlerësim të gjendjes së burimeve natyrore (pyjet, ujërat, toka) dhe menaxhimit të tyre në gjashtë vende të Evropës juglindore (Shqipëri, Bosnje-Hercegovine, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi), pasuar nga një analizë e ecures aktuale të përputhshmërisë me legjislacionin dhe strategjitë përkatëse Evropiane për burimet natyrore. Bazuar në këtë analizë, raporti përcakton një listë çështjesh dhe sfidash thelbësore të cilat kërkojnë ndërhyrje politike, përfshirë përmirësimin e përdorimit të burimeve natyrore dhe rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve, sigurimin dhe promovimin e shërbimeve mjedisore, përqaasje të qëndrueshme në menaxhimin e tokës, përmirësimin e kuadrit institucional dhe ngritjen e kapaciteteve.



Raporti është përgatitur gjatë periudhës Gusht 2016-Qershor 2017 nga ekspertet e burimeve natyrore pranë Grupit Permanent të Punës për Zhvillimin Rural Evropën Juglindore, në kuadër të projektit "Zhvillimi rural nëpërmjet menaxhimit të integruar të pyjeve dhe ujërave në EUL (LEIWW), financuar nga GIZ.

Bashkëbisedime me grupet e interesit për problematikën e menaxhimit dhe identifikimin e impakteve negative në Parqet Kombëtare

Në funksion të iniciativës së Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri, mbi procesin e identifikimit të aktiviteteve me impakt negativ në 16 Zona të Mbrojtura në Shqipëri, Instituti për Ruajtjen e Natyrës organizoi bashkëbisedimet me grupet e interesit për "Problematikën e menaxhimit dhe identifikimin e impakteve negative

në Parqet Kombëtare "Shebenik-Jabllanicë" dhe Divjakë-Karavasta si dhe anketimin individual (plotësimi i pyetësorit), së bashku me organizatat partnere të OJF-ve lokale dhe Administratat e Parqeve Kombëtare.

Në takime ishin të pranishëm grupet e interesit nga këto zona si bujq, fermerë, mësues, OJF lokale, peshkatarë etj. Në takime u diskutua mbi programet dhe punën e administratave të Zonave të Mbrojtura për ruajtjen, menaxhimin dhe promovimin e vlerave të Parkqeve si dhe pati një bashkëbisedim të hapur me grupet e interesit të këtyre zonave.

Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit "Promovimi dhe advokimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura", që mbështetet nga Programi SENIOR-II dhe i zbatuar nga REC Albania.



Mblidhet Grupimi Të Shpëtojme Arinjtë Shqiptarë

Tiranë 18 Tetor 2017 - Pranë ambienteve të INCA u zhvillua takimi i rradhes i Grupimit Të Shpëtojme Arinjtë Shqiptarë.

Qëllimi i takimit ishte gjendja e aksionit të shpëtimit të arinjve, diskutimi mbi projekte ku çdonjëra organizatë anëtare është e përfshirë dhe mundësia që këto projekte të trajtojnë edhe çështje mjedisore të arinjve në robëri; shkelja e moratoriumit të gjuetisë; vrasjet e arinjve (si psh rasti i Kalasë së Dodës); zgjerimi i grupimit si dhe fuqizimi i tij; etj.

Një vend të veçantë zuri edhe çështja e ariut të sapo shpëtuar nga AdRZM Elbasan dhe Four Paws. AdRZM Elbasan pasi mori njoftim nga banorët e fshatit Polis Valë Elbasan ku një Ari i murrëm



kishte rënë në lak, verifikuan menjëherë në vend dhe njoftuan AKZM / Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe më pas u kërkua ndihma e specializuar nga Organizata "Four Paws", pas mbërritjes të ekipit nga Kosova u bë mjekimi i plagëve dhe lirimi i tij.

Në këtë mision morën pjesë dhe ISHMP, Policia e Shtetit, Bashkia Elbasan etj. Është hera e dytë që AdRZM Elbasan liron arinjtë nga leqet e vëna vite më parë.

Tryezë e rrumbullakët me mediat - Procedurat e VNM/VSM

Tryezë të rrumbullakët me mediat - "Procedurat e VNM/VSM - analiza, rekomandimet dhe shembujt më të mirë të zbatimit të tyre"

Tiranë, 27.10.2017 - Çështjet mjedisore që shoqërojnë projekte të ndryshme që janë zhvilluar në të gjithë vendin janë një nga pjesët më të rëndësishme të procesit të zbatimit të projektit. Megjithatë është shumë e rëndësishme për t'u marrë parasysh gjatë zhvillimit të projektit dhe për të bërë një plan të mirë të zbatjes ose zvogëlimin ose



shmangien e ndikimit negativ në mjedis, projektet kohë pas kohe nuk llogarisin saktë ndikimet e tyre dhe nuk përfshijnë masat për zbatjen / shmangien e ndikimeve të tyre. Ky proces është ballafaquar me reagimin e komunitetit për të protestuar ose

kundërshtuar projektet dhe kërkesat e komunitetit për të marrë pjesë në konsultimet / diskutimet publike dhe më tej në procesin e vendimmarrjes për këto projekte. Por kjo kërkesë nuk respektohet siç duhet dhe situata e

kundërt kur komuniteti është duke u bërë pjesë e konsultimit publik dhe procesit të vendimmarrjes, projekti ka marrë konsensus midis pjesëve dhe ka përfunduar në një rast të favorshëm për publikun dhe autoritetet dhe për më tepër për më shumë qëndrueshmëri dhe

zhvillim ekonomik miqësor me mjedisin.

Ngritja e vetëdijes dhe njohurive të tyre për transparencën publike dhe pjesëmarrjen e publikut në konsultimet e projekteve të ndryshme dhe rolin e medias në këto aktivitete duke reklamuar takimet dhe

Vijon në faqe 9

Vijon nga faqe 8 mundësitë e diskutimit ndërmjet autoriteteve publike, investitorëve dhe



komunitetit, ishte tema kryesore e sesionit të trajnimit që ekipi i projektit CO-SEED në Shqipëri ka organizuar për dhe me përfaqësuesit e medias. Ekipi i projektit CO-SEED në Shqipëri zhvilloi këtë trajnim për të krijuar një urë komunikimi dhe angazhuar mediat në procesin e informimit, diskutimit dhe vendimmarrjes së komunitetit në zhvillimin e projekteve të ndryshme që kanë ndikim në mjedis.

Trajnimi u përqendrua në rëndësinë e gazetarëve dhe medias - vizuale dhe të shkruara - në rritjen



e ndërgjegjësimit të publikut për të marrë pjesë aktive në planifikimin dhe zhvillimin e projekteve dhe krijimin e një mendimi ku publiku mund të gjejë mënyrat e tij të informimit dhe komunikimit për t'u angazhuar gjatë proceseve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Në këtë trajnim morën pjesë dhjetë përfaqësues të medias dhe ndoqën trajnimin gjysmë ditor ku organizatorët shpjeguan se çfarë janë VNM dhe VSM, cilët janë autoritetet publike përgjegjëse për to dhe cilat janë detyrimet e kuadrit ligjor dhe institucional për të angazhuar publikun në këto procese. Koordinatorja e projektit shpjegoi në përgjithësi

qëllimin e projektit dhe pasi eksperti ligjor bëri një prezantim të shkurtër mbi pikat e shtyllave kryesore të Konventës së Aarhusit (Qasja e Publikut në Informacion, Pjesëmarrja e Publikut dhe Qasja në Drejtësi) dhe se si media mund të bëjë lajme ose artikull për ta për të ndihmuar komunitetin për informimin, pjesëmarrjen dhe dhënien e mendimit të tyre në vendimmarrje.

Të gjithë gazetarët shprehën interesimin për temën dhe bënë një diskutim produktiv për angazhimin e medias për prezantimin e çështjeve të mjedisit në edicionet e tyre, gazetatat apo mediat sociale. Ato dhanë



propozime të frytshme se si të rritet interesi i gazetarit për të marrë pjesë në këto aktivitete dhe se si OSHC-të mund t'u japin atyre informacion, fakte dhe zhvillime gjatë proceseve të VNM dhe VSM.

Në fund të trajnimit, ekipi i projektit prezantoi manualin mbi praktikën më të mira globale për bashkëpunim të suksesshëm midis organizatave të shoqërisë civile, autoriteteve publike dhe kompanive private në vendimmarrjen për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe vlerësimet strategjike mjedisore.



Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni www.co-seed.eu

Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?



CO-SEED

*Fragmente nga manuali i praktikave
më të mira botërore*

Shteti: Hungari

Rasti: VSM-ja e Planit Strategjik Kombëtar të Peshkimit dhe Programi Operacional për Peshkimin

Theksi: Njoftim transparent dhe në kohë i të gjitha përditësimeve për dokumentacionin e projektit.

Objektivi i VSM-së për Planin Strategjik Kombëtar të Peshkimit dhe Programin Operacional për Peshkimin në Hungari ishte të ofronte propozime të zbatueshme për përmirësimin e performancës mjedisore të politikës së peshkimit dhe për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit, si dhe duke ndihmuar në shmangien e ndërhyrjeve të shtrenjta ndër të tjera.

U hartua një plan për konsultimet publike, i cili përfshinte sigurimin e shpërndarjes së përshtatshme të informacionit si më poshtë:

i gjithë informacioni i gjeneruar gjatë VSM-së (duke përfshirë edhe versionet projekt të Planit Strategjik, Programit, dhe Vlerësimit, si dhe

komentet nga konsultimet publike, etj.) iu vu në dispozicion publikut në faqen e internetit të Shoqatës Kombëtare të Mbrojtësve të Mjedisit (NSC), i cili mund të aksesohet drejtpërdrejtë nga faqja e internetit të ministrisë përkatëse dhe konsulentit ekspert.

dokumentet kyçe u dërguan me email, dhe për të gjithë ata që nuk kishin akses në internet, iu dërguan të printuara dhe në CD.

përditësimet e sistematike, kryesisht të fazave kyçe të procesit të planifikimit, u publikuan në faqet e internetit dhe në rrugë të tjera (p.sh deklarata për shtyp, reklama në gazetatat ndërkombëtare, etj.).

informimi nëpërmjet emailit i organizatave profesionale dhe OJQ-ve më të rëndësishme mjedisore për fazat e para të vlerësimit profesional.

informimi nëpërmjet emailit i përdoruesve të regjistruar rreth dokumenteve të publikuara në faqen e internetit, si dhe rreth përfundimit të vlerësimit mjedisor dhe datës së fillimit të periudhës së konsultimit prej 30 ditësh.

Shoqëri pjesëmarrëse në vendimarrje

nga Qendra EDEN

Në kuadër të projektit "Shoqëri pjesëmarrëse në vendimmarrje" Qendra EDEN ndoqi dëgjuesen e organizuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve, Ministria e Transportit dhe Infrastruktura. Në këtë takim u diskutua për temat që do të përfshihen në raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor—Master Plani Kombëtar i Ujësjetës

EDEN e zbaton këtë projekt në kuadër të projektit "Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social-Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm" Co-Seed Project (CO-SEED) me fonde të Bashkimit Evropian dhe që zbatohet nga Inca Shqipëria



In the framework of the project Participatory society in decision making!, EDEN center with the representative of the training EIA/SEA organized from EDEN center attended the hearing organized from The National Water Supply and Sewerage Agency, Ministry of Transport and Infrastructure. In this meeting was discussed for the topic/issues to be included at the Strategic Impact Assessment Report- National Master Plan of Water supply in Albania. EDEN center attended this meeting in the framework of the project Civil society acts for environmentally sound socio-economic development (CO-SEED) Financially supported from EU and Implemented in Albania from INCA ALBANIA



Kuriozitete nga Zonat e Mbrojtura në Shqipëri

Peshkaqeni dhelper ne rrjetat e peshkatave te Orikut

Një Peshkaqen dhelper ka rënë në rrjetat e peshkatave të Orikut.

Në bashkëpunim me prof. Rigeres Bakiu dhe Inspektorin e AdRZM Nexhip Hysolako u evitetua dhe u bënë matjet e këtij ekemplari. Duhet theksuar që kjo specie është në zhdukje prandaj u bëhet thirrje kujtqdo që operon në sektorin e Peshkimit që nëse e gjejnë këtë specie të gjallë, duhet ta lëshojnë në det. Kjo do të thotë një mundësi me shume për mbijetesën e kësaj specie.

Burimi: Qendra e peshkimit Radhime



NJOFTIME

- 1 Nëntor - Java e Ujit në Shqipëri
- 8 Nëntor - Dita Botërore e Urbanizimit
- 18 Nëntor - Dita Botërore e Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS)
- 25 Nëntor - Dita Ndërkombëtare e Eliminimit të Dhunës ndaj Grave
- 27 Nëntor - Java Europiane për Reduktimin e Mbetjeve

1 - Vacancy announcement for IUCN Nexus Central Asia Coordinator to work with the IUCN Global Water Programme and Regional Environmental Centre for Central Asia (CAREC) on an EU funded Nexus project aiming at sustainable long-term economic growth and human wellbeing in Central Asia. Deadline for applications is 12 November 2017

https://hrms.iucn.org/vacancy/2656?dm_i=2GI3,15KIJ,426J43,3KPEF,1

2 - Për të lexuar "Ditari i Natyrës" në vite...

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Grupimi "Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë"



Organizatrat Partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Adr.: Rruga "Islam Alla"
Pallati IVEA, Kati I
1001 Tirana-Albania

Tel.: +355 (0) 422 31 437
Fax: +355 (0) 422 31 437
E-mail: info@inca-al.org

www.inca-al.org
info@inca-al.org
www.facebook.com/inca.albania

INCA ALBANIA

